

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nis konferenca e matematikës në Akademinë e Shkencave
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/nis-konferenca-e-matematikes-ne-akademie-e-shkencave-i587015
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 07:20:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 15:17:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1806801ca286d9ca7a8328001da0d42a5914235a9c9172516dff052214e0dc4d
TEKSTI	c508c2c489d43d0c25bd010becbf9beb959ebc3929468c23d43956699a05e86e
PAMJA	775f0d29f97a44d3557708e9fae00334c6b821b7ccbc6c7f7035f1d0522f5a4e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d9995f55f68cafb50044ee0b8a52e98f2dcca27e6cf41708dd3b23bcc2fb84
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d9995f55f68cafb50044ee0b8a52e98f2dcca27e6cf41708dd3b23bcc2fb84>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1e "Ose NATO hyn ne lufte, ose do te kemi nje Lufte Njeqindvjeçare" - Le Pen: Rreziku i pershkallezimit eshte realÇelet ekspozita me foto te rralla te Nene Terezes ne CODAike fundit

Nis konferenca e matematikës në Akademinë e Shkencave



19 Shtator 2026, 17:17Kulturë TEMA



Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë nisi dje konferenca ndërkombëtare dyditore kushtuar zhvillimeve bashkëkohore në matematikë, e organizuar nga Instituti Kombëtar i Matematikës, pjesë e ASHSH-së, në bashkëpunim me departamentin e Matematikës të Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës dhe me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

Konferenca "Western Balkan Conference on Mathematics and Applications (WBCMA 2026)"

u mbajt me synimin për t'u dhënë hapësira të rëndësishme përfaqësuesve të komunitetit akademik e studiuesve për shkëmbimin e ideve, prezantimin e rezultateve të reja kërkimore dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e matematikës.

Kryetari i seksionit të Shkencave Natyrore Teknike, Neki Frashëri, në fjalën përshëndetëse në emër të kryesisë së ASHSH-së vuri në dukje veçantinë e kësaj veprimtarie shkencore dhe nënvizoi më tej rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet universiteteve të Tiranës dhe Prishtinës.

Gjithashtu, ai vlerësoi praninë e ekspertëve të huaj në këtë veprimtari, duke veçuar pjesëmarrjen e njërit prej matematikanëve më të njohur të analizës matematiko-komplekse dhe teorisë së funksioneve harmonike në rajon, akademikut David Kalaj nga Mali i Zi.

Në fund të fjalës së tij, Frashëri uroi për mbarrëvajtjen e punimeve të konferencës dhe premtoi vijimin e takimeve dhe bashkëpunimeve shkencore edhe në të ardhmen.

Dekania e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, prof. dr. Eglantina Kalluci, falënderoi pjesëmarrësit dhe vuri në dukje rëndësinë e konferencës për forcimin e bashkëpunimit akademik dhe shkencor ndërmjet institucioneve pjesëmarrëse; nxitjen e shkëmbimit të njohurive dhe krijimin e lidhjeve më të forta brenda rajonit dhe me komunitetin shkencor ndërkombëtar për zhvillimin e kërkimit matematik dhe krijimin e partneriteteve të reja shkencore.

Më tej, prof. dr. Kalluci shprehu mirënjohjen dhe falënderimet për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Universitetin e Prishtinës për bashkëpunimin dhe kontributin në organizimin e konferencës, si dhe për profesorët, akademikët dhe kërkuesit që kontribuan në pasurimin e programit shkencor.

Një moment i veçantë i hapjes së punimeve të konferencës ishte edhe dorëzimi i certifikatës së anëtarësimit si anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për akademikut David Kalaj. Certifikata iu dorëzua nga kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Skënder Gjinushi.

Prof. Kalaj, një figurë e shquar e shkencës, i njohur ndërkombëtarisht për kontributet e tij të gjera në fushën e matematikës, është zgjedhur anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave me vendimin nr. 42, datë 14.07.2025, të Asamblesë, sipas nenit nr. 6 të ligjit nr. 53/2019, “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”.

Në fjalën e tij prof. Kalaj shprehu mirënjohje të thellë për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për vlerësimin dhe falënderoi kryetarin Gjinushi për realizimin e kësaj procedure. Ai e cilësoi anëtarësimin në Akademi si nderin më të madh që ka arritur deri tani.

Më pas Kalaj çeli sesionin e konferencës me prezantimin e njëres nga arritjet e tij më të mëdha shkencore, duke zgjidhur përfundimisht dy probleme të hapura prej dekadash në matematikën botërore: Hipotezën e Gausit dhe Hipotezën Nitsche-Hopf për lakueshmërinë e sipërfaqeve minimale. Përmes një metode gjeniale gjeometrike, profesori nga Tuzi (Mali i Zi) arriti të vërtetojë kufijtë absolutë të lakueshmërisë së këtyre sipërfaqeve (të njohura në jetën e përditshme si cipat e sapunit).

Ky zbulim i madh shkencor, i cili u botua në revistën prestigjioze ndërkombëtare Duke Mathematical Journal, përbën një kontribut të jashtëzakonshëm në gjeometrinë diferenciale globale dhe lartëson emrin e shkencës shqiptare në nivelet më të larta akademike në botë. Punimet e konferencës do të vijojnë edhe më 19 shtator me sesionet e tjera shkencore dhe prezantimet e studiuesve pjesëmarrës.

Aktiviteti do të vijojë me paraqitjen e mbi 45 referimeve, përfshirë ligjërata plenare dhe prezantime në sesione tematike, ku marrin pjesë rreth 60 studiues dhe pedagogë nga Shqipëria, Kosova, vendet e Ballkanit Perëndimor dhe institucione partnere ndërkombëtare.

Programi shkencor përfshin një gamë të gjerë temash në matematikën e pastër dhe të zbatuar, ndër të cilat analiza Fourier dhe Gabor, metodat e elementeve të fundme për zgjidhjen e ekuacioneve diferenciale pjesore, gjeometria e manifoldëve Nehari–Kähler, teoria e shkallës për manifoldet topologjike, integralet e McShane, ekuacionet diferenciale me rend fraksional, hapësirat metrike dhe operatorët M-quasi-paranormalë, si dhe tema të tjera në analizë, gjeometri dhe teorinë e operatorëve.

Gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarie shkencore do të prezantohen dhe diskutohen rezultatet bashkëkohore në matematikë, nxitja e shkëmbimit të njohurive dhe përvojave, mbështetja e doktorantëve dhe studiuesve të rinj, si dhe forcimi i bashkëpunimit institucional dhe i rrjeteve kërkimore. A.K./TemA

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Çelet ekspozita me foto të rralla të Nënë Terezës në COD

09:12 Kulturë

Teuta: anatomia e një simboli, estetika e pushtetit dhe paradoksi i monumentit

21:32 Kulturë

Ekspozohen 101 vepra arti në Lagjen e Parë të Gjirokastrës

17:19 Kulturë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.